



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni hetimor “Për kontrollin e veprimtarisë së organeve të administratës publike dhe pushtetit vendor për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 25 prillit 2021”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.10.2021, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Enkelejd Alibeaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit hetimor.
2. Zgjedhja e sekretarit të komisionit.
3. Administrim i kërkesave të anëtarëve të komisionit për marrje provash e të dhënash për çështjet e parashikuara në planin paraprak të hetimit.

Marrin pjesë:

Enkelejd Alibeaj, Toni Gogu, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Aurora Mara, Klevis Xhoxhi, Nasip Naço, Bardhyl Kollçaku, Gazment Bardhi, Oerd Bylykbashi, Ferdinand Xhaferraj, Ervin Salianji, Kreshnik Çollaku, Petrit Vasili dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Petro Koçi.

HAPET MBLEDHJA

Enkelejd Alibeaj – Mirëmëngjesi, kolegë!

Hapim mbledhjen.

Sipas verifikimeve të bëra nga ana e administratës dhe nga unë, siç e shihni, fizikisht kuorumi është. Kështu që, për këtë arsye konsiderohet zyrtarisht e hapur çelja e mbledhjes, që do të thotë se teknika e lëshon menjëherë sinjalin. Medie të futet brenda.

Mirëmëngjesi edhe një herë për medien!

Çelim mbledhjen e radhës së komisionit hetimor.

Siç jeni në dijeni, mbledhja e kaluar pati atë zhvillim që pati, e mbyllur sipas rregullave të ligjit për komisionet hetimore. Pra, fakti që kuorumi ra, veprimtaria u ndërpre në atë moment dhe, sipas edhe kërkesave të ligjit për komisionet hetimore, u caktua data e mbledhjes për ditën e sotme, 27 tetor, ora 11:00, me rendin e ditës që ju është shpërndarë të gjithë anëtarëve të komisionit dhe në këtë pikë dua të sqaroj diçka. Nga verifikimet që kam bërë, i drejtohem administratës së Kuvendit, mund të jem gabim, por nga verifikimet e bëra deri para pak kohësh rendi i ditës dhe njoftimi për mbledhjen e komisionit hetimor nuk është pasqyruar në faqen e Kuvendit, siç ka ndodhur në rastet e tjera. Kam pasur ankesa nga mediet. Nëse kjo nuk është e vërtetë, unë tërhiqem dhe kërkoh ndjesë, por nëse është e vërtetë, kjo është një çështje që nuk duhet të përsëritet më. Mbledhjet e komisioneve dhe, sidomos, të komisioneve hetimore janë të detyrueshme për t'u shpërndarë nëpërmjet faqes së parlamentit jo vetëm për njoftim të publikut, por edhe për efekt të transparencës, si një detyrim që buron edhe nga Rregullorja e Kuvendit. Në këto kushte, jam i detyruar të bëj edhe një pasqyrim të rendit të ditës. Në përfundim të asaj mbledhjeje, e cila përfundoi, për fat të keq, me mungesë të kuorunit, kam shpërndarë njoftimin për rendin e ditës së mbledhjes së sotme, sipas këtyre pikave:

Pika e parë është administrimi i kërkesave të anëtarëve të komisionit për marrje provash e të dhënash për çështjet e parashikuara në planin paraprak të hetimit. Ju e dini fare mirë që plani paraprak i hetimit u miratua që në mbledhjen e parë konstituente të këtij komisioni.

Pika e dytë është zgjedhja e sekretarit të Komisionit. Kjo për arsyen e thjeshtë se, përderisa nuk u ezuarua dot, kjo është një pikë e rendit të ditës, e cila do të ezaurohet edhe si njëloj detyrimi ligjor.

Dua t'ju vë në dijeni se nga anëtarët e Partisë Socialiste ka një zëvendësim sot. Zoti Gogu, nëse më ndihmon, shoh që është i pranishëm zoti Qefalia në rolin e zëvendësuesit

sepse mungon zoti Petro Koçi, pra nuk është i pranishëm, dhe zëvendësohet nga zoti Xhemal Qefalia.

Në këto kushte, fillojmë me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës, që është administrim i kërkesave të anëtarëve të komisionit për marrje provash e të dhënash për çështjet e parashikuara në planin paraprak të hetimit.

Për sqarim, në rendin e ditës së imponuar nga ligji dhe, tashmë, të miratuar, ju kujtoj që 4 pikat e para të rendit të ditës janë të miratuara dhe e katërta është ajo e planit paraprak të hetimit. Plani paraprak i hetimit është lënda e parë mbi të cilën secili nga anëtarët e komisionit, në bazë të instrumenteve dhe të drejtave që ka....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zoti Kollçaku, sepse do t'ju jap fjalën, pa merak!

Po sqaroj një gjë për publikun dhe për ju, që besoj se ju jeni shumë të interesuar për këtë çështje.

Pra, plani paraprak i hetimit është lënda e parë, e cila, në bazë të të drejtave të çdo deputeti, anëtar i komisionit, ka të drejtën të bëjë kërkesa për të dhëna, dokumente, fakte dhe prova për ta pasuruar atë, për ta arritur kështu në momentin final, që është miratimi i planit të hetimit.

Në planin e hetimit paraprak është parashikuar edhe kalendari i këtyre veprimeve. E mbani mend fare mirë që në datën 29, pra pas dy ditësh, është kërkesa që duhet të bëjë secili nga deputetët për të marrë dokumente zyrtare, pastaj në datën 14 nëntor është momenti kur do të miratohet plani i hetimit final. Kështu që kjo ishte për sqarim.

Për procedurë fjalën e ka zoti Gogu.

Toni Gogu – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Më 14 tetor me vendimin nr. 79 Kuvendi na delegoi pushtetin të hetojmë përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 25 prillit, na ngarkoi ne, të 15 anëtarëve të komisionit, që ta kryejmë këtë punë. Zoti Alibeaj na caktuan ne të dy, ju si kryetar dhe mua si zëvendëskryetar, që, në zbatim të nenit 10 të ligjit “Për komisionet hetimore”, ta drejtojmë veprimtarinë e tij në përputhje me atë ligj dhe me Rregulloren e Kuvendit. Kanë kaluar 12 ditë dhe, fatkeqësisht, vendimi i Kuvendit nuk po gjen dot zbatim.

E ngjizët veprimtarinë e këtij komisioni në shkelje flagrante të ligjit; e nisët duke mos hedhur në votim rendin e ditës, gjë që vazhdoni ta bëni edhe sot; e përshkallëzuar në refuzim për të zgjedhur nga radhët e anëtarëve sekretarin e komisionit, reflektuar kjo si refuzim i

zbatimit të nenit 10, pika 2, të ligjit “Për komisionet hetimore” dhe kulmuat duke hartuar një rregullore, sipas mendjes tuaj dhe jo sipas vullnetit të këtij komisioni, siç parashikon neni 24 i ligjit “Për komisionet hetimore”. Kërkesat tona për të hedhur në votim rendin e ditës, zgjedhjen e sekretarit, hartimin dhe miratimin e rregullores, tashmë janë mbuluar nga kapica e shkeljeve të bëra nga ju, zoti kryetar, për të arritur në mbledhjen e fundit, ku neve, shumicës, na u mohua e drejta e votimit, e drejta votës në komisionin, ku do të hetojmë se si qytetarët e kanë ushtruar këtë të drejtë në zgjedhjet e fundit. Na u nëpërkëmb e drejta që na jep neni 24 i ligjit “Për komisionet hetimore”, e drejta për t’u bërë pjesë e hartimit dhe e miratimit të rregullave të brendshme të komisionit dhe se si besoni se mund ta drejtoni një komision të tillë, ku gëzoni pakicën, pa konsideruar fare as vullnetin dhe as votën e shumicës, vetëm ju e dini. Sidoqoftë, ne kemi durimin e mjaftueshëm që sot të ripërsëritim kërkesën tonë që t’i ktheheni logjikës së ligjit.

Ju lutem, zoti kryetar, mblidheni veten, vini rregull dhe rend në punimet e këtij komisioni; mblidheni veten dhe vini rregull, sepse nuk mund të na pengoni të ushtrojmë të drejtën e votimit të rendit të ditës, siç na e përcakton neni 38 i Rregullores së Kuvendit. Ky komision, nën drejtimin tuaj, ka detyrimin të administrojë siç duhet zbatimin e objektivit të katërfishtë, brenda kohës së kufizuar që na ka caktuar Kuvendi. Mblidheni veten dhe vini rregull, sepse nuk mund të na pengoni që të ushtrojmë të drejtën e votimit të zgjedhjes së sekretarit të këtij komisioni, siç e përcakton neni 10 i ligjit “Për komisionet hetimore”, sepse vetëm kështu ky komision mund t’i japë drejtim morisë së çështjeve administrative dhe teknike. Mblidheni veten dhe vini rregullin në këtë komision, sepse nuk mund të na ndaloni të hartojmë dhe të votojmë së bashku rregulloren e brendshme. Kemi propozuar amendamentet për rregulloren e brendshme, siç përcakton neni 76 i Rregullores së Kuvendit. Ky komision ka nevojë që t’i hartojë dhe t’i miratojë me votim rregullat e nevojshme për funksionimin e tij, në përmbushje të objektivit që Kuvendi ka ngarkuar. Në udhëkryqin ku e keni futur veprimtarinë e këtij komisioni nevojitet me urgjencë të mblidhni veten dhe të filloni më në fund të drejtoni me maturi. Nëse vërtet duam që hetimi parlamentar i zgjedhjeve të 25 prillit të bëhet realitet dhe jo *show* politik nga ata që argëtojnë mbrëmjeve, nevojitet drejtim i matur.

Së pari, dhe në sytë të gjithë nevojitet drejtim i matur nga ju, zoti kryetar. Detyra e çmuar dhe fisnike e kryetarit të këtij komisioni jua kërkon që ta drejtoni dhe ta moderoni mbledhjen në mënyrë të paanshme, duke u kujdesur që edhe koha në dispozicion të secilit anëtar të jetë e barabartë dhe synimi juaj i vetëm të jetë shterimi i rendit të ditës dhe mbarëvajtja e mbledhjeve. Vetëm kështu ju do të largoni çdo anshmëri dhe arbitraritet.

Së dyti, nevojitet qëndrim i matur nga ju, kolegë të opozitës. Objektivi i punës së këtij komisioni është hetimi dhe jo debati me ne për të na treguar në fillim atë që duhet të dalë në fund të hetimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Hetimi, që kërkohet nga ne (po citoj ligjin edhe për anëtarin e nderuar të komisionit tonë), është një tërësi veprimesh procedurale që ndërmerren nga ky komision pa marrë të pandehur dhe pa ngritur akuza penale, është neni 2, pika 3, i ligjit. Vetëm duke hetuar mbështetur në prova do të mund t'i verifikojmë pretendimet tuaja, por edhe shqetësimet e parashtruara nga partnerët dhe vëzhguesit ndërkombëtarë.

Së treti, nevojitet qëndrim i matur nga ne, kolegët e shumicës, pasi Gjykata Kushtetuese na i ka kornizuar detyrat e hetimit brenda kompetencave që përfshihen në përgjegjësinë kushtetuese të Kuvendit, pa hyrë në sferën e kompetencave të organeve të tjera.

Zoti kryetar,

Të dashur kolegë të opozitës, duhet t'i japim drejtim situatës në të cilën ndodhemi, duke nderuar dhe duke respektuar njëri-tjetrin, por, mbi të gjitha, ligjin. Nuk keni, nuk kemi dhe nuk ka rrugë tjetër.

Ju falënderoj!

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Gogu!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, cila ishte kërkesa për procedurë?

Toni Gogu – Të hidhni në votim rendin e ditës. Brenda rendit të ditës të jetë zgjedhja e sekretarit nga radhët, si dhe të hartojmë e të miratojmë rregulloren e brendshme të këtij komisioni.

Ju falënderoj!

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit!

Sipas Rregullores, sa herë që ka një kërkesë për procedurë, një folës pro, një folës kundër. Ka ndonjë folës kundër këtej nga ana juaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Vasili, do t'ju jap fjalën nëse do të kishit një kërkesë tjetër, por lidhur me këtë kërkesë...

Po, zoti Bardhi, për procedurë gjithmonë.

Gazment Bardhi – Për procedurë, zoti kryetar, besoj që kërkesa e bërë nga kolegu është një kërkesë e përsëritur dhe është ezauruar, të paktën në tri mbledhje të këtij komisioni. Rendi i ditës caktohet nga kryetari. Nëse anëtarët e nderuar të komisionit kanë çështje për të

përfshirë në rendin e ditës, ia propozojnë kryetarit dhe futet në rend dite, por nuk votohet nga komisioni rendi i ditës. Se ne kemi ardhur të përgatitur për këtë rend dite që na ka njoftuar kryetari i komisionit. Me shumicë ju mund ta ndërroni rendin e ditës. Mbledhjet nuk bëhen në mënyrë të papërgatitur, kjo është e para.

Për sa i përket rregullores, edhe atë e kemi diskutuar. Ka një draft të propozuar nga kryetari, nisi shqyrtimi mbledhjen e shkuar, kemi kaluar fazën e miratimit në parim me votë unanime (pra, drafti i propozuar nga kryetari ka marrë votë unanime të miratimit në parim nga të gjithë anëtarët e komisionit) dhe kemi kaluar në shqyrtimin nen për nen. Me sa kujtoj nga mbledhja e shkuar, është kaluar deri në nenin 17. Sigurisht, sipas edhe rendit të ditës që ju lexuat, do të vazhdojmë shqyrtimin nen për nen aty ku është lënë, në momentin kur kolegët e maxhorancës u larguan, duke bojkotuar mbledhjet e komisionit. E përsëris, kam dëgjuar bojkot të opozitës, pra largim nga veprimtaria parlamentare e opozitës, por është hera e parë që në këtë komision hetimor hasim bojkot nga kolegët e shumicës.

Kështu, të mos humbim kohë, në gjykimin tim, me çështje procedurale, të cilat i kemi ezauruar disa herë. Qëllimi i përbashkët, me sa kuptova edhe nga fjala e zotit Gogu, është që të nisim hetimin. Ju na keni dhënë shansin e mundësinë nëpërmjet rendit të ditës që kemi sot të nisim realisht hetimin. Ju lutem, të kalojmë te çështjet që lidhen me të dhënat që do të duhet të hetojë ky komision, më pas të ndjekim me përpikëri rendin e ditës, siç është propozuar.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Bardhi!

Shoh dorën e zotit Kollçaku të ngritur për procedurë. Sipas Rregullores, sa herë ka një kërkesë për procedurë, flet njëri pro, foli zoti Gogu, dhe njëri kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kam sugjerim për ju. Nuk do t'jua heq fare të drejtën për të kërkuar fjalën, por e kam vetëm sugjerim se, nëse do t'jua juve fjalën, do të jem i detyruar t'ia jap edhe një anëtar nga pala tjetër që do të thotë se do të shkojë si një zinxhir, do të humbasim kohë dhe do t'i hyjmë në hak asaj çfarë kemi për detyrim, pikërisht që një orë e më parë të ecim me hetimin.

Zoti Kollçaku, keni fjalën.

Bardhyl Kollçaku - Në cilën rregullore thuhet që është vetëm një herë për procedurë?

Atëherë, faleminderit zoti kryetar!

U bë hera e tretë ose e katërt që ne mblidhemi, shkelim ligjin për ngritjen e komisioneve hetimore me të dyja këmbët, shkelim Rregulloren e Kuvendit, kur themi:

“Zbatojmë Rregulloren e Kuvendit”, me të dyja këmbët, bëjmë lojëra fjalësh, bëjmë atë *show-n* mediatik, që e thashë edhe në seancë plenare, dhe nuk prodhojmë asgjë. Vullneti i shumicës dhe i pakicës ka qenë i plotë, kur u votua ngritja e komisionit hetimor dhe ne jemi këtu për të kontribuar në mënyrë shumë serioze për mbarëvajtjen e këtij komisioni. Si ka mundësi që shkelet ligji, se kemi 3 ose 4 herë që jemi mbledhur dhe nuk zgjidhet sekretari i komisionit?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Mos fol, kur flas unë! E ke pasur 3 herë në rend dite. Kur flas unë, të lutem, mos fol! Nuk të kam ndërprerë asnjëherë. E kemi pasur 3 herë në rend dite dhe 3 herë e kemi anashkaluar. Është kërkesa e parë e ligjit për komisionet hetimore që në mbledhjen e parë. Cila është mbledhja e parë, sot apo ajo që bëme para 10 ditësh? Së pari.

Së dyti, kur thuhet: “I zhvillojmë këto mbledhje në përputhje me Rregulloren e Kuvendit”, këtu në rendin e ditës duhet të ishte procesverbali i mbledhjes së kaluar, që duhet të ishte miratuar me konsensus, në qoftë se ka pasur.

Së treti, te neni 10 i ligjit për ngritjen e komisioneve hetimore thuhet: “Të gjitha mbledhjet bashkëdrejtohen nga kryetari dhe nënkryetari i komisionit”, pa përjashtim dhe ju me të drejtën që shtypni dhe ndizni mikrofonin e keni shkelur këtë të drejtë.

Ne këtu jemi të gjithë të barabartë, ju jeni i parë midis të barabartëve. Ju lutem, drejtojeni këtë komision ashtu siç e ka ligji, Rregullorja e Kuvendit. Jemi këtu për të ofruar bashkëpunimin tonë, që të miratohet rregullorja dhe nuk mund të quhet e miratuar në parim rregullorja, siç thotë zoti Bardhi, kur kanë qenë vetëm 7 vota nga ju dhe 7 vota nga ne dhe ju thoshit “miratohet”. Si mund të miratohet me 7 vota kundër dhe me 7 vota pro?

(Ndërhyn deputeti Gazment Bardhi pa mikrofon.)

Po flas unë, zoti Bardhi.

Apo është vota e kryetarit që numërohet për dy? Ku e keni gjetur këtë?

Ju lutem, të fillojmë nga ajo që tha nënkryetari: të miratojmë rendin e ditës.

Enlekejd Alibeaj – Zoti Vasili.

Petrit Vasili – Tani, për sa i takon pjesës së procedurës, ne kemi insistuar shpeshherë të citojmë ligjin, pavarësisht se leximet e tij bëhen si duan, por ta lexojmë edhe një herë tjetër, për sa i takon drejtimit të komisionit, që ta zgjidhim këtë çështje një herë e mirë e pastaj të shkojmë më tej.

Ligji përkatës thotë: “Mbledhjet drejtohen nga kryetari dhe me autorizimin e tij nga zëvendëskryetari i komisionit” te neni 12, me titullin “Zhvillimi i mbledhjeve”, pika e parë, kështu që boll me këtë. Ka mënyra të tjera për të bërë obstrukcionizëm, për ta penguar, ka

plot edhe këtu në këto ditë kemi parë të tilla. Por këto referimet e ligjit janë kaq të qarta, sa nuk ka ku të shkojnë më. Në qoftë se ka një njeri që nuk kupton dot kur thuhet që e drejton kryetari dhe me autorizimin e tij e drejton zëvendëskryetari, atëherë ky është një problem që nuk kemi pse shkojmë më tutje. Së pari.

Së dyti, me thënë të drejtën, ne nuk kemi kohë këtu për të shpenzuar, që të përdoret koha e mbledhjes për alibitë e bojkotimit sistematik që bën maxhoranca. Nuk është halli i këtij komisioni, as është objekti i punës. Në qoftë se ikin është vendimi i tyre politik, nuk e gjykon njeri, por nuk vijmë dot këtu, që këtë vendim politik, që u duk qartë që ishte i gabuar dhe i trashë, të na e shesin si procedurë, se është për fajin e disa të tjerëve që rrinë këtu deri në fund.

Së treti, për të qenë në rregull nga ana procedurale, është thënë e zeza mbi të bardhë (megjithëse në pjesën e parë që dëgjuam kishte dhe kamera, prandaj ishte goxha e ndezur situata, madje duhej njoftuar që në momentin që ikin kamerat kthehemi në normalitet) dhe këtu u tha qartë dhe u pranua nga të gjithë, sepse ashtu është vërteta, që s'kemi pasur një draft të kryetarit, por kemi pasur një draft pune të nisur nga precedentët e tjerë. Drafti quhet i kryetarit, kur ai bashkë me të tjetër e përgatisin dhe thotë: unë kam përgatitur këtë gjë. Për të qartësuar fillimin e punës, u qartësua që nuk ka një draft të tillë, ky është një material pune i hapur për diskutim, i hapur për t'u diskutuar dhe ndaj u vunë një dy relatorë nga secili krah, që ta sillnin këtë material në parametra të tillë, që të diskutohej dhe të miratohet, eventualisht të shikoheshin edhe ndryshimet, dhe këtë nuk e luan as topi. Në rast se do bëhemi kaq...

Kaq karakter të fortë duhet ta kemi, pavarësisht detyrimeve politike, kur gjëja është e shkruar e zeza në të bardhë, që është një draft për të fituar kohë. Nuk u pranua, dakord, vazhduam më tej.

E fundit, përmendet vazhdimisht çështja e zgjedhjes së sekretarit. Ky është një problem i vogël, se është e qartë që nuk ka ndonjë surprizë në zgjedhjen e sekretarit të famshëm. Duhet gjetur ndonjë argument i ri obstruktiv, se ky nuk vlen më, për të shtyrë punën e komisionit. E kemi thënë qartë se në fillim miratohet Rregullorja, e cila përshkruan qartë edhe mënyrën e votimit të sekretarit, sepse, nëse nuk kemi Rregullore, nuk kemi si votojmë sekretarin. Po i them këto meqenëse vazhdimisht përmenden ligji, rregullat, Rregullorja e të tjera. Këto janë të shkruara e zeza në të bardhë.

Në rast se duam të ecim përpara, le ta votojmë atë pjesë të mbetur të ndryshimeve nën për nën të Rregullores, në rast të kundërt, le ta thonë qartë që nuk duan ta vazhdojnë edhe këtë mbledhje dhe ne të shkojmë të merremi me punë të tjera, se nuk kemi vetëm këtë punë, që t'i bëjmë shërbim këtij obstruksionizmi.

E fundit, meqë ka pasur dëshirë për të pasur vetëpërmbytje, edhe kur përdoren figuracione të caktuara në fjalë, që kanë konotacion fyes, duhet të evitohen më shumë nga ata që predikojnë shumë e shumë për një gjuhë të tillë, sepse vetëpërmbytja, e para, është reciproke dhe e dyta, që të jetë e paanshme, duhet të duket nga të dyja krahët. Në qoftë se mospërmbytja në njërin krah është e mirë dhe e paqme, kurse ajo në krahun tjetër na mërzit, kjo është anshmëria më e keqe dhe më e shëmtuar që mund të ekzistojë.

Kështu që, në qoftë se duam që kjo punë të shkojë përpara, hajde ta mbyllim çështjen e Rregullores me ato që na kanë mbetur dhe të bindemi njëherë e përgjithmonë që për vendimet të tilla të karakterit përfundimtar, siç është miratimi i një rregulloreje, fatkeqësisht ligji ka një përcaktim “shumë të keq”, që miratohet me votat e të gjithë anëtarëve. Nuk është një vendim i ndërmjetëm që mund të votohet vetëm me votat e shumicës. Nëse nuk e duan dhe duan ta bëjnë vetëm me votat e tyre, le ta bëjnë, por nuk e lejon ligji. Është i paligjshëm si votim.

Këto janë elemente procedurale, të cilat nuk i kapërcejmë dot.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Vasili!

Për sqarim, pasi dëgjova të dyja palët lidhur me pretendimet respektive, e para, e pranoj plotësisht ftesën e bërë nga zëvendëskryetari, zoti Gogu, për tone të qeta, për vetëfrenim dhe për të vendosur në plan të parë, atë që është interesi më së pari i këtij komisioni dhe më tepër sesa kaq, edhe i Kuvendit të Shqipërisë, i cili ka miratuar ngritjen e këtij komisioni: të ecim një orë e më parë me hetimin.

Së dyti, lidhur edhe me pretendimet tuaja, më bëtë thirrje për të mbledhur veten. Unë jam i mbledhur këtu, kam qenë i mbledhur këtu, të tria këto mbledhje të komisionit hetimor, por nuk ju mbledh dot ju. Nuk ju mblodha dot në datën 20 tetor, kur kishim caktuar datën dhe orën e mbledhjes. Nuk erdhët. Nuk ju mblodha dot se ikët pa arsye nga mbledhja e mëparshme, pasi kishim filluar votimin. E votuam në parim dhe arritëm deri te neni 17. Për korrektesë, neni 5 nuk është miratuar gjatë shqyrtimit **nen për nen**, për shkak të raportit të votave, kurse gjithë të tjerat janë miratuar. Ikët. Nuk ju mbledh dot. Nuk kam ndonjë fuqi të mbinatyrshme për t’ju mbledhur. E vetmja fuqi që gjithsecili prej nesh këtu ka është t’i qëndrojmë strikt ligjit “Për komisionet hetimore”, Rregullores së Kuvendit dhe, mbi të gjitha, dëshirës së sinqertë për të hetuar, për të kryer punën, asgjë më shumë.

Për këtë arsye, lidhur edhe me kërkesat tuaja procedurale, më thatë të hedh në votim rendin e ditës. E keni përsëritur këtë kërkesë në të gjitha këto mbledhje. Po jua rikujtoj, edhe pse ju e dini fare mirë, që ligji “Për komisionet hetimore” në nenin 11 për mbledhjen e parë konstituuese të tij, në pikën 4 thotë këtë gjë: “Kryetari deklaron qëllimin e ngritjes së

komisionit, përcakton detyrat e komisionit, si dhe planin paraprak të hetimit”. Pra, “deklaron”. E kam detyrim prej ligjit. E kam deklaruar. Nuk e hedh dot në votim, se nuk më thotë ligji ta hedh në votim. Është kaq e thjeshtë!

Për çështjet e tjera, në detyrim të ligjit, edhe të traditës parlamentare të mëparshme, rregulloren, sekretarin dhe eventualisht caktimin e datës së mbledhjes pasardhëse, e kam bërë në mënyrë sistematike, deri në bezdisje.

Çfarë ndodhi mbledhjen e mëparshme? Pikën e rendit të ditës, pra të miratimit të rregullores, e filluam mirë e bukur. Kishim rënë dakord me kërkesën tuaj, të zonjës Bushka, në traditën më të mirë të këtyre komisioneve, dhe rregulloren, draftin e paraqitur prej meje, pa bërë asnjë lloj shpikjeje, po të marrë ashtu siç është përdorur rregullorja tip në komisionet e tjera të mëparshme, e ofrova si draftin mbi të cilin do të duhet punuar. Madje, pati deri edhe tallje pse draftrregullorja, e paraqitur prej meje, e huazuar nga komisionet e mëparshme, kishte referenca të komisioneve të mëparshme. Pikërisht për këtë arsye, për të treguar që nuk i kam futur duart aspak, e kam marrë siç ishte më parë, për të respektuar traditën parlamentare, ramë dakord që dy përfaqësues, një nga ju, një nga ne, të bashkëpunonin dhe të binim dakord për formulime të dakordësuara. Këtu ishin si përfaqësuesi juaj, si përfaqësuesi ynë, dhe nuk ranë dakord. Arsyetimet tashmë janë të qarta. Propozimet që vinin nga ana juaj ishin të tilla që përmbysnin jo frymën, por germën e ligjit. Në ligj thuhet se e drejta për të marrë prova pranohet pa votime. Propozimi juaj: e drejta për të marrë prova i nënshtrohet votimit. Këtë e kupton kushdo. Ju keni shumicën, siç e thoni me shumë krenari, siç është dhe ligji, në fakt, që do të thotë se çdo kërkesë për të marrë prova do të rrëzohet në mënyrë sistematike prej shumicës, duke eliminuar atë që është thelbi i komisioneve hetimore, të drejtën për të marrë prova, të drejtën për të hetuar. Të drejtën e drejtimit të komisionit? Unë nuk jam hipokrit në këtë mes, i përkas opozitës. Për këtë arsye jam në drejtimin e këtij komisioni, se në ligj kështu thuhet, që kryesimi i komisionit i përket opozitës. Për këtë arsye ju keni shumicën. Duke respektuar Rregulloren e Kuvendit dhe ligjin, me respektin individual për gjithsecilin, jam munduar që koha, radha e fjalës dhe kërkesat procedurale të jenë të barabarta, aq sa pata dhe atakime nga pala këtej, por nuk kam asnjë lloj problemi në këtë pikë.

Kështu që rendin e ditës nuk e hedh dot në votim, sepse e ka përcaktuar ligji. Çfarë do të bëjmë ne, do ta kthejmë ligjin mbrapsht?! Ne, 15 burra dhe gra, të nderuar ose jo, do të ndryshojmë ligjin e miratuar që në 2002-shin nga parlamenti shqiptar?! Nuk e bëjmë dot.

Për sa i përket sekretarit, e keni në rendin e ditës dhe këtu dua të sqaroj diçka. Në mbledhjen e shkuar, të dështuar jo për fajin tonë, se ne jemi të mbledhur, por ju nuk jeni, se

ikët, kam propozuar dhe kam përcjell nëpërmjet sekretariatit të komisionit këtë rend dite, prandaj dhe e thashë në fillim: e para, administrimi i kërkesave të anëtarëve të komisionit për marrje provash e të dhënash për çështjet e parashikuara në planin paraprak të hetimit. Kjo është punë konkrete, ky është hetim, ky është hapi procedural, që e fut komisionin në veprimtarinë e vet substanciale: të mbledhë të dhëna, të mbledhë fakte, të plotësojë, të pasurojë planin e hetimit paraprak, në mënyrë që të arrijmë pasandaj, sipas kalendarit, në miratimin e planit të hetimit.

Nuk e kam lënë vetëm me kaq, se pika tjetër është pikërisht ajo që kërkoni ju, zgjedhja e sekretarit të komisionit. Çështjen e rregullores, realisht, prisja ta kërkoni sot. Përderisa e kishim si pikë të rendit të ditës, nuk e ezauruam dot, se ju ikët, arritëm deri te neni 17, sigurisht që duhet të ishte një kërkesë juaja. Jam dakord. Pika e tretë e rendit të ditës të jetë miratimi i rregullores.

Po ju them diçka, se duhet ta them: kemi rënë dakord dhe kemi marrë vendim në mbledhjen e parë që mbi draftrregulloren e paraqitur nga unë, të huazuar nga komisionet e mëparshme, të ketë dakordësi midis zotit Naço dhe zotit Salianji. Ai vendim është ende në fuqi. Besoj se kjo është rruga më e mirë, më e logjikshme, për të na mbledhur të gjithë ne dhe për të mos ikur nga ky komision. Ky është propozimi im.

Të vazhdojmë me rendin e ditës:

E para, administrimi i kërkesave të anëtarëve për të dhëna për prova.

E dyta, zgjedhja e sekretarit.

E treta, rregullorja e komisionit.

Besoj se kjo i përfshin të gjitha kërkesat, të gjitha interesat për të ardhur në hullinë e ligjit dhe për të vazhduar me hetimin.

Ju kujtoj se anëtarët e opozitës kanë bërë kërkesa, kanë mbledhur të dhëna, për të cilat kërkojnë të administrohen, sipas ligjit të komisioneve hetimore, dhe të fillojmë sa më parë me ezaurimin e të gjitha këtyre pikave.

Faleminderit!

Xhemal Qefalia – Zoti kryetar, për procedurë.

Enkelejd Alibeaj – Po, zoti Qefalia, për procedurë.

Xhemal Qefalia – Kjo është mbledhja e parë që unë marr pjesë.

Enkelejd Alibeaj – Po, e keni këtë të drejtë.

Xhemal Qefalia – Konkretisht, habitem me ju, nisur edhe nga përvoja e gjatë politike që keni, që e keni futur komisionin në një ngërç të tillë.

Ka një përvojë parlamentare dhe disa kolegë kanë marrë pjesë edhe në komisione të tjera. Qytetarët janë të interesuar të dinë se çfarë ka ndodhur më 25 prill, besoj edhe ju jeni më shumë të interesuar për këtë pjesë...

Enkelejd Alibeaj – Sigurisht.

Xhemal Qefalia – ... dhe nuk mund të fusësh komisionin në një ngërç të tillë, duke mos respektuar rregullat dhe përvojën që ka parlamenti në ngritjen e komisionit.

Ju vërtet jeni përfaqësues i opozitës, por, në rastin konkret, jeni kryetar i komisionit, jeni kryetar edhe për ne të mazhorancës.

Enkelejd Alibeaj – Sigurisht.

Xhemal Qefalia – Zoti kryetar, ditën e parë, habitem pse keni frikë ta respektoni deri në 1 konstituimin që i bëni komisionit. Sekretari mund të zgjidhet normalisht. Pse do që ta ngecësh në komision: do ta fusim pikë të dytë apo do ta fusim pikë të tretë? Krijohet kryesia e komisionit e përbërë nga kryetari, nënkryetari dhe sekretari. Zoti kryetar, ne nuk mund të dërgojmë asnjë shkresë pa firmën e sekretarit për të adresuar apo për të bërë planin paraprak.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Ta dëgjojmë, ju lutem!

Xhemal Qefalia - Ju lutem, zoti kryetar, respektojuni këtë gjë!

Më pas të kalojmë te rregullorja.

Enkelejd Alibeaj – Dakord.

Xhemal Qefalia – Të vendosim norma dhe rregulla për funksionimin e komisionit.

Qytetarët nuk janë të interesuar të dëgjojnë ku ka shkelje të nenit, por të ulemi dhe të përcaktojmë planin paraprak, siç është normale, dhe të hedhim kërkesat tuaja.

Ne, gjithashtu, kemi kërkesa të tjera për t'i futur në agjendë dhe për t'i bërë prezent në komision.

Të fusim komisionin në hulli, siç tha edhe nënkryetari.

Është turp të ndalemi nëse do të vazhdojmë me këtë pikë apo me atë pikë.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Qefalia.

Ju nuk keni qenë anëtar i komisionit dhe, duke mos pasur informacion për mbledhjet e tjera, mund të thoni disa gjëra të pasakta, por është e tolerueshme.

Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, përtej faktit që dikush mund të jetë i ri në mbledhjet e komisionit, komisionet parlamentare hetimore janë tashmë histori shumë e vjetër. Ligji

është gati 20-vjeçar, praktika është 20-vjeçare, rregulloret standarde tipike kanë qenë gjithmonë kështu, siç po kërkojmë ne të miratohet.

E kam thënë në mbledhjen e kaluar dhe e përsëris: komisionet janë ndërtuar në mënyrë specifike në vitin 2002. Ai që e kërkon, ai e drejton komisionin. Maxhoranca ka gjithmonë maxhorancë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Zoti Qefalia, ju lutem të dëgjojmë kolegun!

Oerd Bylykbashi - Unë ju respektova.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligji e ka të përcaktuar: “E kërkon opozita, e drejton opozita; e kërkon mazhoranca, e drejton mazhoranca. Në çdo rast, mazhorancën e ka mazhoranca.”

Nuk ekziston koncepti që komisioni hetimor drejtohet me kryesi. E përsëris: ky komision nuk mund të ndryshojë ligjin me vendimmarrjet e tij, qoftë duke miratuar rregullore në kundërshtim me ligjin, dhe aq më pak ideja se mund të vendoset kufizimi i funksionimit edhe me dërgimin e shkresave, kërkesës sime, si anëtar i këtij komisioni, për mbledhjen e provës, që sekretari i komisionit të mendojë se mund të bllokojë kërkesën time për hetim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Zoti Qefalia, ju lutem!

Oerd Bylykbashi – Pra, nuk ekziston mundësia ligjore ...

Enkelejd Alibeaj – Zoti Qefalia, ju lutem!

Oerd Bylykbashi - Ky komision, në asnjë rast, nuk mund të shkelë ligjin në këtë mënyrë flagrante. E kuptoj përpjekjen. Sigurisht që qëllimi ynë është ta fusim në hullinë e hetimit të shkeljeve që ka bërë maxhoranca, ndërkohë që qëllimi juaj është ta fusim të hullia, te tubi se si të dalë uji nga krahu tjetër për atë që ju intereson juve. Jo. Hullia e vetme është hetimi i shkeljeve që ka bërë qeveria, shteti, duke u përfshirë në zgjedhje.

Tani ju jeni palë në konflikt interesi, por jo për këtë arsye ju mund të përcaktoni rregulla që, kur të kërkojmë ne provat, ju të na e bllokoni me firmë sekretari. Nuk ekziston kjo. Keni një të drejtë tjetër. Bëni një raport paralel me ne, më shumë se kaq nuk bëni dot.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Nuk do të vazhdojmë me dorën përpjetë për procedurë. Sipas rregullit, flet njëri, flet tjetri, i kam marrë të gjitha kërkesat.

Urdhëroni, zoti Bardhi për procedurë!

Gazmend Bardhi – Realisht kërkoj që të mos e merrni si propozim të opozitës, por si një propozim për nxitur që puna e komisionit të ecë përpara.

Ka disa kërkesa nga kolegët. Ka një orë që jemi marrë peng dhe nuk po vazhdojmë dot përpara. Unë mendoj që, duke qenë se në mbledhjen e shkuar ju e përmendët kërkesën e zonjës Bushka në emër të kolegëve të maxhorancës që zoti Klevis Xhoxhi të jetë sekretar i komisionit, unë mendoj të procedojmë dhe të hedhim në votim dhe ta miratojmë sekretarin e komisionit dhe më pas rezervoj të drejtën time të marr fjalën për të nisur punën konkrete për të dhënat e hetimit.

Duke qenë se kemi një ngërç për rregulloren dhe që të mos rrimë si në mbledhjen tjetër 3 orë për rregulloren, kërkoj mirëkuptimin e kolegëve që ta lemë si pikë të fundit diskutimin për rregulloren.

Pra, të hedhim në votim sekretarin, ta zgjedhim sekretarin, sepse është pikë e mbartur nga dy mbledhjet e shkuara, të vazhdojmë me administrimin e të dhënave nga secili prej kolegëve dhe në fund t'u rikthehemi, për aq sa do të jetë e nevojshme, diskutimeve që kanë kolegët për shqyrtimin e rregullores.

Mendoj se ky është një propozim që i akomodon çështjet në të dy krahët dhe na lejon të ecim përpara, se kemi 1 orë që jemi duke diskutuar dhe nuk po e kuptoj për çfarë jemi duke diskutuar.

Enkelejd Alibeaj – Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Jemi komision hetimor i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nuk jemi organ i partive politike që na kanë dhënë detyrën për të qenë në këtë komision si përfaqësues dhe duhet të sillemi sipas atyre normave që rregullojnë veprimtarinë institucionale të një komisioni hetimor.

Kjo veprimtari normohet me ligjin “Për komisionet hetimore” dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Sipas ligjit “Për komisionet hetimore” është e vërtetë që mbledhjen e thërret kryetari dhe e njofton atë, por drejtimin e të gjithë punës së komisionit hetimor, sipas nenit 10 të ligjit “Për komisionet hetimore”, e bën kryetari dhe zëvendëskryetari. Kryetari dhe zëvendëskryetari i komisionit drejtojnë gjithë veprimtarinë e tij në përputhje me këtë ligj, si dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Kjo është pika e parë e nenit 10, që flet për çështjen se si drejtohet veprimtaria e komisionit hetimor. në pikën 11 flitet për mbledhjen e parë të komisionit dhe unë jam dakord

me kryetarin (ka caktuar çështjet e rendit të ditës sipas nenit 11), ama është ceduar me pikën 2 të nenit 10, ku thuhet që në mbledhjen e tij të parë, zgjedh nga radhët e tij, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, një sekretar, i cili drejton çështjet administrative.

Po mendojmë ta rregullojmë pas tri mbledhjeve. Logjika është që pse duhej të harxhonim tri mbledhje për të arritur te kjo pikë? Do të ecim përpara duke vënë në shina veprimtarinë e komisionit hetimor.

Ne jemi këtu të zgjedhur për një detyrë shumë të rëndësishme. Ju e kondicionuat zgjedhjen e sekretarit të komisionit me miratimin e rregullores.

(Debate në sallë)

Le t'i themi gjërat siç janë, se as nuk ikëm ne, as nuk u larguam, por ne reaguam ndaj një veprimi arbitrar në shkelje të rregullave të ligjit "Për komisionet hetimore" dhe të Rregullores, të cilat qartësisht nuk u respektuan nga ana e kryetarit të komisionit.

Ajo që dua t'ju them është kjo: në qoftë se ne të gjithë, siç shoh dhe siç kuptoj nga vullneti i të gjithëve, duam të fillojmë një orë e më parë hetimin, atëherë do të duhet të kemi në konsideratë një gjë shumë të rëndësishme: si mund të prodhojmë një rezultat hetimi të besueshëm, në qoftë se ne, që në mbledhjet e para këtu, kryetari i pari, nuk respektojmë rregullat e ligjit "Për komisionet hetimore" e të Rregullores së Kuvendit, që normojnë veprimtarinë tonë?

Çfarë po ju kërkojmë ne sot? Atë që ju kemi kërkuar që në seancën e parë: t'u përmbahemi pikave të rendit të ditës; kryetari dhe nënkryetari i komisionit, në kuptim të nenit 10 të ligjit "Për komisionet hetimore" të këshillohen me njëri-tjetrin për drejtimin e punëve të këtij komisioni; të miratojmë një Rregullore, e cila nuk është opsionale, por e kemi detyrim nga ligji "Për komisionet hetimore", në mos gaboj, është neni 24, pika 2, që thotë: "Për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së tij, komisioni hetimor i Kuvendit harton dhe miraton rregulloren e brendshme."

E kemi detyrim këtë gjë. Pra, duhet të bëjmë çdo hap procedural që na takon si komision hetimor, për të vënë në vijë të drejtë gjithë aktivitetin tonë, që është parakushti procedural, që rezultati i këtij hetimi të jetë gjithashtu i besueshëm. Kush do të na besojë ne, kur nuk u respektohen ligjet dhe Rregullorja, në lidhje me rezultatin në fund.

Prandaj, unë i qëndroj kërkesës së zotit Gogu, nënkryetarit, që duhet hedhur në votim kërkesa jonë, për t'u shtuar në rendin e ditës vijimi i shqyrtimit të Rregullores së Kuvendit. Kjo jo sepse ju thoni: në rregull, po e vë unë, po për faktin se, sipas ligjit "Për komisionet hetimore" dhe sipas Rregullores, kështu është procedura. Nuk mund të cedojmë. Kryetari nuk mund të marrë përsipër kompetencat e komisionit. Pra, ju keni kompetencat tuaja, të cilat ne

do t'i respektojmë me rigorozitet, por ama rregulli është ky. Atëherë, hidheni në votim kërkesën tonë, Sepse kjo është çështje e standardit, dhe standardi është ky: të zbatojmë Rregulloren me përpikëri.

Atëherë, ne kërkojmë të hidhet në votim kërkesa e zotit Gogu, që rendi i ditës të ketë edhe shqyrtimin dhe miratimin e rregullores së komisionit. Kaq është kërkesa jonë. Për të mos vijuar me paragjykitime: jo ju intereson, jo s'ju intereson. Ne jemi këtu, pra. Na intereson të gjithëve, në interes të publikut.

Prandaj kjo ishte, për ta përsëritur. Ju lutem, hidheni në votim, sipas kërkesës që ju propozoi zoti Gogu.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zonja Bushka!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të ta jap. Ju e dini fare mirë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo. Ju lutem!

Po jua dhashë juve fjalën në kapërcim të Rregullores, do të ketë gjithmonë edhe nga pala tjetër kapërcim të Rregullores, dhe unë, për të mos diskriminuar askënd, unë do të jem i detyruar t'ia jap.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, le të vazhdojmë me atë kërkesë procedurale që u bë. Cila është kërkesa procedurale, pra?

Petrit Vasili – Kam vetëm një gjë për të thënë. Mund ta them me një fjali.

Enkelejd Alibeaj – Të lutem, zoti Vasili, të mos bëhemi pengesë tani...

Petrit Vasili – Ka mundësi një sentencë, me mirëkuptim?

Enkelejd Alibeaj – Dakord! Tani, kjo do të shkaktojë kosto, që do të flasë edhe ndokush nga ana tjetër.

Petrit Vasili – Vetëm një fjali.

Enkelejd Alibeaj – Zoti Vasili, atëherë.

Petrit Vasili – Në rast se do të vazhdojmë me zgjedhjen e sekretarit, atëherë ka një gjë tjetër. Thuhet që këtu, në të gjitha parashikimet në draft-rregullore, që flasin për sekretarin, hiqen. Sepse në Rregullore ekzistojnë parashikimet si zgjidhet sekretari, ndërkohë që ne do të zgjedhim sekretarin, dhe është po e njëjta rregullore. Tani, ne mund të tallemi me njëri-tjetrin, mund të ketë lloj-lloj gustosh, por unë nuk kam gusto të tallem.

Enkelejd Alibeaj – Dakord!

Petrit Vasili – Po që se votohet sekretari, unë do të them se s' marr pjesë në votim...

Enkelejd Alibeaj – Dakord! Faleminderit!

Meqë ju dhashë fjalën juve, me të drejtë tani e ka fjalën zoti Naço, për barazi armësh.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

Sigurisht që fillimi i mbarë është gjysma e punës. Pra, e kemi lënë në gjysmë të Rregullorja, që e kaluam në parim. E lamë që ta vazhdonim nen për nen, për ato me të cilat ne do të binim dakord. Drafti parashikonte rreth 24 nene. Ato për të cilat ranë dakord, do t'i kalonim, ndërsa pjesën tjetër do t'i diskutonim, nuk do t'i votonim. Pra, thamë t'i diskutojmë, të biem në konsensus bashkërisht. Të diskutojmë atë çfarë ka ligji, çfarë ka Rregullorja e Kuvendit, dhe rregullorja që miratojmë ne, të jetë me konsensus. Pra, në momentin kur ju vazhduat deri te neni 5 dhe nuk e hodhët në diskutim, jo në votim, të diskutojmë që të jetë ky draft që paraqisni ju, apo ai që kemi ne.

Pra, unë dhe zoti Salianji, me dëshirën e mirë të të dyve, pavarësisht se komunikuar në distancë, ramë dakord deridiku. Pjesën tjetër e lamë të shqyrtohej në këtë komision. Nëse ne do të vazhdojmë te neni 5, ku e lamë, ju të jepni opsionin tuaj, në përputhje me ligjin, sigurisht do ta gjejmë gjuhën dhe konsensusin për të vazhduar më tej.

Në lidhje me propozimin e zotit Bardhi, për zgjedhjen e sekretarit, është e disata herë që zoti Gogu ka kërkuar që në fillim, dhe ju keni thënë që, të miratojmë rregulloren, se s'mund ta bëjmë. Unë jam dakord ta bëjmë, se e ka ligji. Viheni pak në pozitë të vështirë, por vetëm pak, nuk ju rëndon mbi ato shkelje që keni bërë.

Për procedurë, meqë jemi te procedura, dhe ju citoni gjithmonë 13/4, unë do të doja vetëm të lexoj ligjin, se çfarë thotë për vendimet e ndërmjetme, që të gjejmë një gjuhë midis nenit 2, vendimit të ndërmjetëm dhe 13/4-ës. Po e zgjidhëm këtë, ky komision do të ecë mbarë, ndryshe nga komisionet e tjera. Nëse u referoheni vetëm komisioneve të tjera, të gjitha komisionet e tjera kanë dështuar me sukses. Nëse doni të dështoni me sukses, është e drejta juaj. Ne duam që të hetohet. Unë dua që gjithsecili, se jemi fokusuar vetëm te neni 13/4, të lexojë nenin 2, ku flitet për vendimet e ndërmjetme; çfarë janë vendimet e ndërmjetme, të biem dakord me konsensus dhe kaq; e ka ligji e të vazhdojmë më tej.

Në nenin 2, pika 7, thuhet: "Vendimi i ndërmjetëm është vendimi i komisionit i marrë sipas këtij ligji në çdo fazë të hetimit për ndërmarrjen e procedurave të mëtejshme të hetimit, të pyetjes së dëshmitarëve, thirrjes së ekspertëve, kërkimit të informacionit dhe dokumenteve zyrtare dhe që nuk përmban asnjë konkluzion përfundimtar,". Pra, nëse çdo kërkesë për hetim dhe marrje provash të një deputeti nuk do të hidhet në votim, por do të kanalizohet nëpërmjet këtij neni dhe këtij paragrafi që do të jetë vendim i ndërmjetëm kur të dalë.

Nëse do të duhet një votë, meqenëse keni minorancën, do ta jap unë në çdo rast që do ta kërkonte. Por ju e keni bllokuar, sepse doni që në çdo rast ta kanalizoni.

Sa për frikën e hetimit të zgjedhjeve, personalisht nuk kam frikë për çfarë ka ndodhur në qarkun e Beratit, sepse i ka qartësuar më së miri drejtuesi juaj politik, i cili ka deklaruar në seancë: “Dua ta nis nga fillimi. Falënderoj jashtë mase qytetarët e Beratit, të cilët u angazhuan dhe bënë një fushatë të pastër. Për mua ishte e rëndësishme për të bërë një fushatë të pastër. Atje ishte një fushatë e pastër”, Tomor Alizoti në seancë, datë 16.09.2021.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë besoj se kur drejtuesi politik në qarkun e Beratit e ka garantuar dhe e ka certifikuar, janë të zgjidhura. Edhe pse Partia Socialiste mori një mandat më shumë, viktimat në këtë rast ishin ata që ikën.

Enkelejd Alibeaj – Të mos bëjmë, si quhet, batatë të kryqëzuara.

Zoti Naço, të falënderoj për fjalën që the! Të falënderoj edhe për faktin që ofruat garancinë tuaj se vota juaj, në rast se do të ngecnim ne, do të ishte këtej, në mënyrë që të vazhdonte hetimi, kjo është bujari e madhe politike. Vetëm se unë kam një problem të madh në këtë mes: garancinë për të drejtën për të hetuar, pra për të marrë prova, nuk mund ta bazoj te bujaria e zotit Naço, as e zotit Alizoti, me thënë të drejtën, por duhet ta bazoj te ligji. Kështu që frymën konstruktive, po, e vlerësoj.

Të kalojmë te kërkesat procedurale. Ka një kërkesë procedurale lidhur me ndryshimin e rendit të ditës, një e bërë nga zoti Gogu, një nga zoti Bardhi, sipas kësaj përmbajtjeje: “Zgjedhja e sekretarit të komisionit, të kalojë si pikë e parë e rendit të ditës dhe në rendin e ditës si pikë e tretë të shtohet edhe vazhdimi i shqyrtimit dhe i miratimit të rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit hetimor. Ndërkohë që pikë e dytë mbetet ajo që kam vendosur, që është kërkesa për të vazhduar hetimin, kërkesat e deputetëve për të mbledhur të dhëna.

Për këtë arsye, a biem dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më duhet ta hedh në votim, sipas kërkesës suaj. Ta mbarojmë këtë proces dhe do ta keni edhe të drejtën për procedurë.

Propozim që rendi i ditës të vazhdojë me këto pika: pika e parë të jetë emërimi i sekretarit të komisionit, sipas procedurës dhe kërkesës që ju keni bërë. Mbaj mend që ka qenë një propozim për zotën Klevis Xhoxhaj.

Së dyti, administrimi i kërkesave të anëtarëve të komisionit për marrjen e provave dhe të dhënave.

Së treti, çështja e rregullores.

E hedh në votim këtë propozim. Kush është pro? Gjashtë. Kundër? Tetë. Abstenim? Asnjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta jap fjalën, pasi të deklaroj rezultatin e votimit.

Që do të thotë se kërkesat e bëra nga palët për ta sjellë rendin e ditës në një veprimtari funksionale, duke akomoduar edhe kërkesën e secilës palë, pra të palës së Partisë Socialiste, për të vazhduar me shqyrtimin e rregullores, së pari; së dyti edhe me kërkesën e ofruar nga zoti Bardhi për ta kaluar si pikë të parë të rendit të ditës, që është zgjedhja e sekretarit të komisionit, u rrëzua fatkeqësisht. Për këtë arsye, rendi i ditës mbetet ai i cili është ofruar prej meje në cilësinë e kryetarit, pa asnjë lloj kompleksiteti, në zbatim edhe të ligjit, që do të thotë vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që është administrimi i kërkesave të anëtareve të komisionit për marrje provash dhe të dhënash për çështje të parashikuar në planin paraprak të hetimit

Blerina Gjylameti – Zoti Alibeaj, kam kërkuar fjalën për shpjegimin e votës kundër.

Enkelejd Alibeaj – Për këtë arsye ia jap fjalën zoti Bardhi, në zbatim të kësaj pike.

Blerina Gjylameti – Atëherë, kërkoj të bëjmë 5 minuta pushim, nëse doni të vazhdoni përsëri me shkelje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Nuk e drejton këtë komision zoti Bardhi, por e drejtoj unë. Fjalën ia kam dhënë zotit Bardhi.

Toni Gogu – Të lutem, më lejoni, zoti kryetar, ju paralajmërova në fillim të mbledhjes, prandaj kërkojmë 5 minuta pushim, që mbledhja të vijë në kufijtë dhe në kornizën e ligjshmërisë.

Enkelejd Alibeaj – Zoti Bardhi, keni të drejtën për të folur.

Fjala për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gazment Bardhi – Të nderuar kolegë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Të mos e konsiderojmë si ikje këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gazment Bardhi – Zoti Gogu, ju realisht nuk dini se çfarë kërkon

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Zoti Bardhi, vazhdoni, sepse kjo duket se është një kërkesë e pastër për të bojkotuar.

Gazment Bardhi – Kërkoni të zgjidhni sekretarin, ju themi zgjidhim sekretarin dhe ikni nga salla...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Ne do të vazhdojmë.

Zoti Bardhi, ju lutem, vazhdoni!

Kryetari deklaroi se kourumi vazhdon, kanë shkuar në banjo dhe do të vijnë përsëri.

Ju lutem, vazhdoni!

Gazment Bardhi – Sipas vendimit nr. 79/2021 të Kuvendit të Shqipërisë, një nga pikat që përbën objekt të punës së komisionit hetimor është verifikimi i përdorimit të të dhënave personale për qëllime elektorale, me nënçështje përdorimin e paligjshëm të të dhënave personale, pushteti vendosi të dhënat personale dhe sensitive të qytetarëve, të administruar prej tij, në dispozicion të një partie politike, konkretisht Partisë Socialiste të Shqipërisë, i njohur ndryshe si sistemi i patronazhistëve.

Sipas një investigimi të publikuar më 11 prill në median “Lapsi.al”, ka arritur

të sigurojë një databazë, ku janë përfshirë të dhënat personale dhe sensitive të të paktën 910 mijë votuesve në qarkun e Tiranës nga moshë 19 deri në 99 vjeç. Dokumenti përmban të dhëna personale, si: numrat e telefonit, numrat e kartës së identitetit, numrin e qendrës së votimit, vendin e punës për shumicën e të regjistruarve dhe një përshkrim të përkatësisë politike për secilin prej qytetarëve të Tiranës, që është fryti i një pune monitorimi të qytetarëve, që ka në themel të saj të dhëna që ne ia kemi besuar shtetit.

Në dokumentin e siguruar nga media e pavarur “Lapsi.al” përkatësia politike e secilit është përshkruar me “Po” ose me “Jo” në një nga kolonat nga personat që janë pjesë e skemës së patronazhit. Në databazë, përmbajtja e të cilave përbën vepër penale, janë të dhënat për 910 mijë qytetarë të Tiranës, të cilët nuk e kanë dorëzuar me vullnetin e tyre informacionin për Partinë Socialiste në pushtet, por u janë vjedhur, që nga numri i telefonit, numri ID-së së kartës së identitetit apo vendi i punës.

Sipas investigimit, ky dokument është shpërndarë në kompjuterët e selisë së Partisë Socialiste në Tiranë, ku bëhej përpunimi i të dhënave dhe e njëjta procedurë ndodhte edhe në selitë e tjera në çdo degë të Partisë Socialiste në qarqet e tjera, duke shpërndarë këtë skemë për të gjithë votuesit në Republikën e Shqipërisë.

Nga një verifikim i thjeshtë rezulton se të dhënat e qytetarëve janë azhurnuar në muajt e fundit. Gjatë kohës së pandemisë E-Albania ka qenë një ndër aplikacionet jetike, ku secili prej nesh është detyruar ta përdorë për një qëllim apo një tjetër.

E-Albania është një zyrë me një ndalesë për shërbimet *online* të administratës publike dhe lidh me platformën qeveritare të ndërveprimit, në të cilat janë 48 sisteme qeveritare, që shkëmbejnë të dhënat e tyre në kohë reale.

E-Albania është krijuar dhe administrohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, që është institucion në varësi të Kryeministrit të Shqipërisë. Të gjitha të dhënat personale, që përpunohen nga portali E-Albania, kanë qëllim vetëm marrjen e shërbimeve të ofruara nga kjo e fundit dhe në bazë të ligjit nuk lejohet transmetimi i këtyre të dhënave për një palë të tretë pa miratimin paraprak të personit që disponon të dhënat. Sistemi i të dhënave përfshin informacione për ministra, familjarë të tyre, drejtorë, prokurorë, avokatë, gjyqtarë, policë, gazetarë të të gjitha medieve në Tiranë, aktorë të angazhuar ose jo në politikë, personazhe të shoqërisë civile dhe të jetës publike, të gjithë nën vëzhgimin e syrit të Partisë Socialiste që shikon përtej ligjit.

Përdorimi i të dhënave personale dhe sensitive vjen në kundërshtim me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, Kushtetutën, Kodin Penal, Kodin Zgjedhor dhe ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Ky krim i shumëfishtë, me përmasa ndërkombëtare, përbën një rast flagrant se si shteti vë në dispozicion të partisë në pushtet, infrastrukturën e tij të plotë në funksion të fitores së zgjedhjeve. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave personale dhe sensitive, për të cilat askush nuk ka dhënë pëlqimin e tij për mbledhjen, përpunimin apo publikimin e tyre, përbën shkelje të ligjit, sikurse është trajtuar në disa çështje në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga ana tjetër, origjina etnike, bindjet, anësia politike dhe pjesëmarrja në shoqata apo sindikata parashikohet, gjithashtu, si një e dhënë sensitive në respekt të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale është trajtuar gjithashtu dhe gëzon mbrojtje në bazë të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Nëpërmjet kësaj skeme kriminale, që cenon rëndë procesin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në mënyrë të paprecendë janë instaluar kompjutera dhe servera në selinë e Partisë Socialiste, duke u përdorur për fushatë të gjitha të dhënat konfidenciale, sensitive dhe personale të qytetarëve të dhëna në portalin *e-albania*.

Duke përdorur të dhënat personale të administruara nga shteti, Partia Socialiste ka disponuar në mënyrë të paligjshme të dhënat personale të qytetarëve në kohë reale, bazuar në qendrat e votimit, të tilla si: a janë apo jo qytetarët të punësuar; a kanë detyrime tatimore; a

kanë aplikuar për shërbime publike, si leje legalizimi, hipoteke apo certifikata të tjera të lëshuara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës; a kanë paguar sigurimet shoqërore; a kanë aplikuar për leje ndërtimi, a kanë aplikuar për licenca apo leje të ndryshme?

Duke e shfrytëzuar informacionin sensitiv të të dhënave personale, si dhe administratën publike, e cila përbëhet kryesisht me persona të emëruar politikisht dhe militantë të Partisë Socialiste, iu drejtuan qytetarëve të eivedentuar nga të dhënat qeveritare, duke u premtuar shërbime, për të cilat ata kishin nevojë në këmbim të votës për Partinë Socialiste. Një javë pas publikimit të investigimit nga media me një veprim të paprecendit Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion dhe Kundër Krimit të Organizuar (SPAK), kërkoi sekuestrimin e pajisjeve të punës në redaksinë “Lapsi.al”, pasi gazetarët e portalit publikuan informacionin nga database elektorale e Partisë Socialiste, ku gjendeshin të dhënat personale për mbi 900 mijë qytetarë të Tiranës.

Lidhur me këtë skandal Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar kallëzim në prokurori ndaj disa shtetasve, përfshirë Kryeministrin Edi Rama, ministrin e Brendshëm, Bledi Çuçi, ministren e asaj kohe të Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, sekretarin Organizativ të Partisë Socialiste, Arben Pëllumbi, drejtoreshën e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Mirlinda Karaçanaj, Bledar Doracaj, drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, Enton Duro, drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve, të cilët me veprime konkrete dyshohen se kanë konsumuar veprën penale “Të shpërdorimit të detyrës, korrupsionit aktiv në zgjedhje, përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike dhe zgjedhore, përhapjes së sekreteve vetjake dhe grupit të strukturuar kriminal”.

Skandali me të dhënat personale u evidentua edhe në raportin paraprak të OSBE-ODIHR-it. Ekspertët dhe vëzhguesit e misionit të OSBE-ODIHR-it shprehen: “Rrjedha e të dhënave personale sensitive, duke përfshirë preferencat politike të zgjedhësve, përbën shqetësim serioz dhe i bën zgjedhësit vulnerabël”.

Gjatë fushatë nëpërmjet një rrjedhjeje informacioni në domenin publik doli një databazë me informacione personale dhe detaje kontakti për afro 900 mijë qytetarë shqiptarë, që përmbante edhe preferencat e tyre potenciale të votimit. Ekzistenca e kësaj databaze në domenin publik u kufizua në mënyrë të pavarur nga OSBE-ODIHR-i. Disa bashkëbisedues të OSBE-ODIHR-it nga partitë kryesore politike besonin se një incident i tillë mund të konsiderohej nga elektorati si shpërdorim i të dhënave personale për interesat e partisë shtet.

Në orët e vona të së shtunës, të datës 24 prill, kryetarja e një tjetër partie në opozitë, Lëvizja Socialiste për Integritet, doli në një deklaratë për mediet për të denoncuar patronazhistët e Partisë Socialiste, të cilët kishin marrë përsipër blerjen e votave në qarkun e

Durrësit, që faktori se sistemi i patronazhimit dhe përdorimi i të dhënave personale nuk ishte një fenomen lokal vetëm për Tiranën, por ishte i shtrirë në të gjithë Shqipërinë.

Më 17 prill 2021, Edi Rama, Kryeministri i Shqipërisë, gjatë një takimi elektoral me të rinjtë në qytetin e Durrësit i falënderoi patronazhistët për punën e bërë, duke pranuar fenomenin kriminal të mbledhjes dhe të keqpërdorimit të të dhënave personale të qytetarëve. Pas zgjedhjeve, Kryeministri rikonfirmoi të njëjtën gjë. Të njëjtën gjë rikonfirmoi edhe zëvendëskryeministri aktual, i cili në një nga seancat plenare, konkretisht atë të datës 14 tetor mori në mbrojtje përsëri sistemin kriminal të patronazhimit, duke pranuar zyrtarisht se poseduesi i këtij sistemi, pra të keqpërdorimit të të dhënave personale të qytetarëve, është partia në pushtet.

Në muajin gusht Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbylli hetimin administrativ për çështjen e patronazhistëve, duke miratuar rekomandimin nr. 44, datë 19.08.2021 “Për kontrolluesin, Partia Socialiste e Shqipërisë”. Komisioneri del në përfundimin se faktet dhe rrethanat e hetimit administrativ nuk krijojnë kushtet për të evidentuar dhe provuar në terma dhe hapa konkretë hetimin, krijimin dhe përdorimin e bazës së të dhënave nga asnjë subjekt hetimi administrativ.

Pra, fakti se një bazë të dhënash personale sensitive ndodhet në serverin lokal të Partisë Socialiste dhe pasurimi i të dhënave është bërë në bazë të një urdhri të brendshëm të Partisë Socialiste, si dhe fakti që është krijuar një mekanizëm për mbledhjen e të dhënave personale sensitive të individëve nuk mjaftoi për Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ish-deputet i Partisë Socialiste. Për Komisionerin mosegzistenca e një baze të dhënash të ngjashme në asnjë territor tjetër të organizmit politik e përjashton Partinë Socialiste nga dyshimi i autorësisë, por në vijim Komisioneri nuk përjashton mundësinë që, për shkak të ngjashmërive të të dhënave, baza të jetë krijuar dhe përdorur nga nivele lokale organizimi politiko-zgjedhor dhe /ose organizime ose struktura të kandidatëve të veçantë. Më tej, duke ngatërruar qëllimisht krijimin dhe përdorimin e bazës së të dhënave me rrjedhjen e saj nga patronazhistët ose persona të tjerë, Komisioneri gjen se mund të kemi të bëjmë me një përdorim të paautorizuar, në tejkallim të qëllimit të përpunimit, mund të kemi të bëjmë me mungesë të masave tekniko-administrative, ka një mangësi në nivel njohurish ose nuk janë marrë masat konkrete për trajnimin e punonjësve.

Në përfundim, shkelja e ligjit dhe Kushtetutës, me një udhëzim të brendshëm të Partisë Socialiste, mbulohet si injorancë ndaj ligjit dhe lehtësohet nga angazhimi serioz për të rikuperuar mangësitë e konstatuara në të ardhmen. Zelli për të mbrojtur këtë shkelje shkon deri aty sa Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e përsëris ish-deputet i Partisë

Socialiste, mundohet të marrë një pjesë të fajit mbi vete, duke theksuar se po rishikonte një udhëzim të vitit 2013 për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të fushatave zgjedhore, në mënyrë që të artikulojë më qartësisht dhe konkretisht përgjegjësitë e subjekteve politike.

Në mbyllje të këtij hetimi, që fakton shkeljet e të drejtave themelore të njeriut, siç janë mbrojtja e të dhënave personale, Komisioneri mjaftohet me 4 rekomandime, që thjesht i kërkojnë partisë në pushtet, Partisë Socialiste ta lexojë më mirë ligjin në të ardhmen.

U urojmë mirëseardhjen dhe rikthimin në komision kolegëve të maxhorancës!

Në përfundim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Kollçaku, unë po bëj detyrën time në zbatim të vendimit të Kuvendit. Nuk kam ndër mend të iki.

Në mbështetje të neneve 14/b, 15/1 dhe 17 të ligjit për komisionet hetimore dhe vendimit të Kuvendit nr. 79 të vitit 2021, për të faktuar atë që konsiderohet si keqpërdoim i të dhënave personale të shtetasve për qëllime elektorale dhe që kanë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gogu, a mund të vazhdoj, ju lutem!

Pra, do të kërkohet, ndër të tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gogu, a mund ta mbaroj?

Unë sigurisht që mund ta mbaroj.

Enkelejd Alibeaj - Kolegë, ju lutem, mos ndërprisni të drejtën e deputetit për të bërë kërkesën e vet.

Gazment Bardhi – Ju lutem, kolegë mos bëni zhurmuesin!

Enkelejd Alibeaj – Zoti Bardhi, vazhdoni, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gazment Bardhi – Zoti Gogu, ju lutem, mbarova, edhe dy fjali kam!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, zotëri, jemi në mbledhje komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Zoti Bardhi, vazhdoni me kërkesën tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gazment Bardhi – Do të kërkohet ndër të tjera...

Enkelejd Alibeaj – Kolegë, mos e ndërprisni. se po vazhdon me kërkesat.

Zonja Gjylameti, ju lutem!

Nuk ia mbyllni dot gojën, po ju kërkohet me shumë etikë që të mos shkelni Rregulloren dhe të lejoni kolegët të vazhdojnë!

Zoti Bardhi, vazhdoni!

Gazment Bardhi – Do të kërkohet, ndër të tjera, por pa u kufizuar vetëm në to, dokumente dhe informacione lidhur me përdorimin në fushatë të të dhënave personale dhe sensitive nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, institucion në varësi të Kryeministrit, nga Ministria e Brendshme, nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Komsioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe, sigurisht, nga subjektet politike.

Faleminderit, zoti kryetar!

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Bardhi!

Ka kërkesë tjetër për të dhëna, për prova shtesë? Zoti Çollaku.

Kreshnik Çollaku – Faleminderit, zoti kryetar!

Lidhur me verifikimin e përdorimit të fondeve publike për qëllime elektorale, synohet të faktohet:

Masakra zgjedhore e 25 prillit...

Enkelejd Alibeaj – Zoti Çollaku, më falni për ndërhyrjen!

Po i them administratës: mbledhja ka filluar, është çelur me kuorumin sipas Rregullores, dhe këtë e deklaroi kryetari. Ju keni detyrat tuaja për të vazhduar transmetimin e kësaj mbledhjeje deri në fund, kur kryetari i komisionit të deklarojë fundin e saj.

Nëse do të merrni urdhra të paligjshëm apo do të keni iniciativë për të ndërprerë sinjalin televiziv, do të jem i detyruar të ushtroj të gjitha të drejtat e mia si deputet dhe kryetar komisioni për gjithkënd nga ju, deri në kallëzim penal.

Ky është një paralajmërim!

Mos u bëni pengesë as ju, si administratë, për vazhdimin e këtij komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonjë, të lutem!

Kush je ti që vjen këtu e na thua?! Nëse do të vazhdohet në këtë mënyrë, do të ketë një kallëzim penal nga i pari deri tek i fundit!

Kreshnik Çollaku – Mos prish mbledhjen, dil përjashta!

Enkelejd Alibeaj - Zoti Çollaku, fjala për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga zonja Luzi.)

Zonjë, je duke shkelur totalisht ligjin!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të të çoj për ndjekje penale ty dhe këdo tjetër!

Zoti Çollaku, vazhdoni me kërkesën tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Garda, zonja nuk është deputete, ju lutem, nxirreni jashtë ambienteve të sallës së Byrosë, sepse nuk është deputete dhe ka marrë vërejtje nga kryetari i komisionit të dalë jashtë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Garda, ju lutem, nxirreni jashtë zonjën në fjalë!

Zoti punonjës i Gardës së Republikës, zbatoni urdhrat e kryetarit të komisionit!

Zoti Çollaku, vazhdoni!

Kreshnik Çollaku – Nëpërmjet verifikimit të përdorimit të fondeve publike për qëllime elektorale, synohet të faktohet:

- Masakra zgjedhore e 25 prillit, si pasojë e dhënies së ndihmës ekonomike, të paga e luftës ose transferta për ndihmë ekonomike ndaj individëve, biznesit të vogël në kushtet e pandemisë, COVID-19 me qëllim maksimalizimin e paligjshëm të votave Partisë Socialiste.

- Dhënia e koncesioneve gjatë periudhës zgjedhore.

- Dhënia e tenderëve mbështetësve të Partisë Socialiste, të cilët janë njëkohësisht edhe persona me rekorde kriminale të denoncuar nga Partia Demokratike në çdo fushatë zgjedhore.

- Përdorimi i parave publike për investime elektorale nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

- Rritja në nivel rekord të shpenzimeve buxhetore në muajin prill.

- Shitblerja e votës si stimul fiskal elektoral lidhur me punësimet në administratë dhe ndryshimin e kursit të këmbimit gjatë periudhës zgjedhore.

- Rritja e numrit dhe blerjes së procedurave të prokurimit për periudhën nëntor-dhjetor 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë nga viti 2016.

- Investimet elektorale në ujësjellës.

Paragrafi 5/4 i dokumentit të vitit 1990 i Kopenhagenit të OSBE-së kërkon që shtetet pjesëmarrëse të ruajnë një ndarje të qartë midis shtetit dhe partive politike. Partitë, veçanërisht, nuk duhet të shkrihen me shtetin.

Ndërkohë, në zgjedhjet e 25 prillit Partia Demokratike nuk kishte përballë një parti politike, por partinë-shtet, sikurse do ta shpjegojmë më poshtë.

Lidhur me ndihmën ekonomike në këmbim të votës për Partinë Socialiste, duke shfrytëzuar varfërinë e skajshme, partia në pushtet ka shfrytëzuar dhënien e ndihmës ekonomike për blerje e votës. Bazuar në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave në periudhën janar-prill 2020, fatura financiare e ndihmës ekonomike ishte 15,9 milionë euro, ndërsa për të njëjtën periudhë në vitin 2021 janë paguar 18,2 milionë euro, pra 2,6 milionë euro më shumë.

Theksojmë se ndihma ekonomike mesatare në Shqipëri llogaritet në 12 euro në muaj për person ose 60 euro në muaj për familje, që do të thotë se, nga një llogari e thjeshtë, bazuar në shifra zyrtare, gjatë periudhës së fushatës janë përfshirë në këtë skemë 53 mijë e 579 persona më shumë ose 10 mijë e 715 familje më shumë se në periudha të mëparshme.

MBYLLET MBLEDHJA